



RAPORT 2020

Shërbimi Social Shtetëror



RAPORT

2020

Janar 2021



TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	Faqe 4
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	Faqe 5-6
DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESËS SË NE DHE PAK	Faqe 7-16
DREJTORIA E KOMISIONIMIT TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA	Faqe 17-21
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE	Faqe 22-29
DREJTORIA E FINANCËS DHE STATISTIKËS	Faqe 30-39
SEKTORI I AUDITIT TË BRENDSHËM	Faqe 40-43
DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME	Faqe 44-50



HYRJE

Ky raport pasqyron aktivitetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror duke përmbledhur edhe aktivitetin e institucioneve të varësisë gjatë vitit 2020.

Raporti është i organizuar me një përmbledhje dhe raportim të detajuar të aktivitetit të çdo Drejtorie në Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH në zbatim të objektivave të institucionit për vitin 2020 dhe në përputhje me strategjinë e MSHMS në fushën e mbrojtjes sociale.

Raportimet për çdo drejtori paraqesin në mënyrë krahasimore veprimtarinë dhe arritjet për 4 vitet e fundit duke evidentuar përmirësimin e dukshëm të performancës së institucionit në të gjithë komponentët e punës së tij:

- Mirëmënxhimin e skemës së ndihmës ekonomike;
- Modernizimin e skemës së Aftësisë së kufizuar;
- Shërbimet e përkujdesit social;
- Mirëadministrimin financiar dhe të burimeve njerëzore;
- Menaxhimi i kujdesshëm i kërkesave dhe ankesave të njerëzve në të gjitha format e paraqitura, përmes platformës së bashkëqeverisjes, medias, rrjeteve sociale apo direkt pranë zyrave të këtij shërbimi.

Viti 2020 për shkak të pandemisë së shkaktuar nga Covid-19 ka patur shumë sfida të cilat kanë ndikuar në planin e aktiviteteve të institucionit. Gjej rastin të shpreh mirënjohje për të gjithë punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social dhe veçanërisht të Drejtorive Rajonale të ShSSH-së dhe institucioneve të përkujdesit social të cilët kanë punuar me përkushtim pavarësisht situatës. Falenderoj organizatat ndërkombëtare dhe lokale, miqtë e donatorët për mbështetjen e dhënë SHSSH-së për arritjen e objektivave të vëna dhe kalimin e sfidave të dala gjatë këtij viti.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

LUNEDA SUFALI



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Vitet 2020, pavarësisht vështirësive të lidhura me pandeminë e Covid-19, u shoqërua me shumë arritje në lidhje me ndihmën ekonomike, aftësinë e kufizuar dhe shërbimet e përkujdesit shoqëror. Objektivat e vendosura në fillim të vitit ishin në përputhje me detyrat funksionale të strukturave të Shërbimit Social Shtetëror dhe në funksion të arritjes së objektivave strategjike të MSHMS në fushën e mbrojtjes sociale.

Objektivat sipas drejtorive:

Ndihma ekonomike dhe Aftësia e Kufizuar

- Menaxhimi i skemës së ndihmës ekonomike;
- Kontroll mbi zbatimin e legjislacionit për Ndihmën Ekonomike në Drejtoritë Rajonale dhe njësitë vendore;
- Monitorim i skemës dhe orientim drejt tregut të punës për anëtarët në moshë aktive pune për familjet përfituese dhe jopërfituese të NE përmes DRSHSSH në bashkëpunim me administratorët shoqërorë dhe zyrat e punës;
- Kontroll mbi zbatimin e legjislacionit për pagesat PAK në Drejtoritë Rajonale dhe njësitë vendore;

Komisionimet e PAK

- Respektim i legjislacionit gjatë procesit të administrimit dhe komisionimit të PAK;
- Dixhitalizimi i dosjeve të PAK (Arkiva Elektronike);
- Komisionimi bio-psiko-social në qarkun Tiranë dhe përgatitjet për Qarkun Elbasan dhe Durrës;

Shërbimet Sociale

- Zhvillimi i shërbimeve shoqërore sipas legjislacionit përkatës;
- Përkujdesje sociale me standarde të përmbushura;
- Përfshirja sociale e grupeve vulnerable;

Shërbimet e brendshme

- Mirëmenaxhim i burimeve njerëzore;
- Ndjekja e ciklit të projekteve;
- Mirëmenaxhim i çështjeve juridike të institucionit;

Financa

- Mirëmenaxhimi i fondeve buxhetore;
- Ndjekja mujore e shpenzimeve me Spitalet që kanë pjesë të aktivitetit të tyre dhe lindjen e bebeve;
- Mirë menaxhimi i aktiveve;



- Transparencë e plotë e shpenzimeve;

Auditi

- Korrupsion zero;

Në mënyrë të përmbledhur veçojmë këto arritje gjatë vitit 2020:

- Për shkak të situatës së shkaktuar nga Covid-19 63.510 kanë përfituar dyfishim të masës së ndihmës ekonomike;
- 669 anëtarë të familjeve përfituese të NE janë punësuar dhe 153 janë orientuar drejt formimit profesional;
- Përgatitje për shtrirjen e modelit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar në Qarkun Berat dhe Durrës;
- Gjatë vitit 2020 SHSSH ka shpërndarë rreth 12.094 çeqe për bebe të porsalindura;
- Në 30 institucione të perkujdesit shoqëror publike, rezidenciale dhe ditore kanë marrë shërbim 1141 persona në nevojë;
- Për herë të parë Shërbimi Social Shtetëror ka aplikuar për një projekt nga Fondet e paraaderimit në BE (IPA).



I. DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESËS SË NE DHE PAK

Objektivat e Drejtorisë së Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK për vitin 2020 kanë qenë të orientuara në dy drejtime kryesore: Menaxhimi i skemës së Ndhmës Ekonomike dhe Kontroll mbi zbatimin e legjislacionit të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar.

Gjatë vitit 2020, Drejtoria e Kontrollit të Pagesës së NE dhe PAK ka funksionuar në bazë të strukturës së SHSSH me dy sektorë, sektori i NE dhe sektori i PAK.

OBJEKTIVI I

RRITJA E EFIKASITETIT TË NDIHMËS EKONOMIKE

1.1 Monitorimi i skemës së ndihmës ekonomike në nivel kombëtar dhe dinamika e së NE

Gjatë vitit 2020 është monitoruar skema e ndihmës ekonomike çdo muaj nëpërmjet përpunimit të të dhënave statistikore progresive sipas bashkive dhe qarqeve duke përfshirë hyrjet e reja dhe asryet e refuzimit, ndarjen sipas kategorive të përfitimit. Të dhënat statistikore janë dërguar çdo muaj në MSHMS. Gjatë vitit 2020 vihet re një rritje e numrit të përfituesve me sistemin e pikëzimit krahasuar me vitin 2018 dhe vitin 2019.

Në tabelë pasqyrohet mesatarja vjetore e përfituesve sipas pikëzimit 2018, 2019 dhe 2020.


Mesatare	Tota kategoritë		Kategoria Familje në Nevojë			
	Nr. Aplikime ve total	Nr.përfituesve total	Nr.aplikime ve kategoria NE	Nr.përfituesve familje në nevojë	Refuzuar total (kategoria NE)	Nga këta refuzuar për mospërputhje
2018	67258	55400	65832	54060	11771	4519
2019	67141	62002	65491	60439	5052	2090
2020	66841	62821	65248	61190	3919	1927

Ndërsa lidhur me trajtimin e familjeve me fondin deri në 6% mesatarja vjetore për 2020 është me 3700 familje në nevojë, një rritje e lehtë krahasuar me vitin 2019 me 3470 familje dhe më e vogël se në vitin 2018 me 4170 familje.

Skema e NE (pikëzim dhe 6%) për 2020 ka qenë shumë dinamike. Në 3 mujin e parë ka qenë konstante. Ndërsa në muajt prill, maj dhe qershor vihet re një rritje e ndjeshme e numrit të aplikimeve dhe numrit të përfituesve si pasojë e pandemisë COVID 19. **Për vitin 2020, muaji qershor shënon numrin më të lartë të përfituesve në total, janë 71.091 familje në nevojë/individë përfitues.** Ndërkohë në muajin korrik dhe gusht ka një ulje të ndjeshme të familjeve që dalin nga skema e ndihmës ekonomike si pasojë e verifikimeve automatike.



Ecuria 2020 Familje në nevojë dhe Kategori të veçanta											
Total kategoritë(Familje në nevojë dhe kategori të veçanta)				Kategoria Familje në Nevojë				Fondi 6 % ecuria 2020			
Muaji	Nr. Aplikimeve total	Nr.përfitues ve total pikezim	Fond (leke)	Nr.përfituesve familje në nevojë	Nga këto hyrje të reja	Refuzuar total (kategoria NE)	Nga këta refuzuar për mospërp	Nr.familje përfitues	Fond(leke)	nr total perfitues (pikezim +6%)	Fond total (leke)
Janar	67480	60703	337532666	59096	2033	6659	2655	2533	7759740	63236	345292406
Shkurt	63805	60750	334350703	59143	1403	2958	1664	2759	8721268	63509	343071971
Mars	63714	60561	333158585	58978	1418	3038	1221	3405	11071088	63966	344229673
Prill	66702	63356	347583575	61761	2852	3285	1137	3522	11558876	66878	359142451
Maj	68941	65579	361279975	63971	2336	3305	852	3790	12476856	69369	373756831
Qershor	70192	67206	364026237	65522	1803	2934	616	3885	12837576	71091	376863813
Korrik	70866	63972	345257231	62367	1393	6706	4844	3784	12513256	67756	357770487
Gusht	67214	63405	341671113	61787	1365	3733	2237	3724	12305156	67129	353976269
Shtator	66898	62783	350775837	61168	1377	4015	1699	3960	13190348	66743	363966185
Tetor	66210	61537	337999032	59884	1361	4537	2826	4080	13579184	65617	351578216
Nëntor	65055	61836	339816099	60143	1509	3110	1529	4273	14360600	66109	354176699
Dhjetor	65015	62167	341622902	60467	1271	2750	1229				341622902
Total			4135073955						130373948		4265447903



Të dhënat që raportohen për fondin deri në 6% janë të dhëna të cilat gjenerohen nga Regjistri Elektronik Kombëtar. 2 mujori i parë janar-shkurt ka një mospërputhje të të dhënave të hedhura në sistem me numrin e familjeve të trajtuara më 6%, pasi duke qenë një modul i ri në sistem, patën vështirësi në hedhjen e të dhënave. Në tabelë mungon numri i familjeve që



trajtohen me fondin deri në 6% për muajin dhjetor, pasi kjo procedurë bëhet në muajin pasardhës (janar 2021).

Gjatë periudhës së shpalljes së gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore u morën masa për distancimin social dhe shmangien e infektimit nga COVID-19 për shtresat në nevojë si dhe u garantua mbështetja ekonomike e tyre duke dyfishuar masën e përfitimit:

- **Në zbatim të Urdhërit të Ministres nr. 213** "Për marrjen e masave për parandalimin e infektimit nga COVID -19 për aplikuesit e ndihmës ekonomike", për periudhën mars-qershor janë marrë të gjitha masat për zbatimin e procedurës së aplikimit dhe përfitimit të NE-së . Fomulari i aplikimit është hedhur në web-in e SHSSH në mënyrë që familjet të kishin mundësi për të bërë aplikimin dhe ta dërgonin me postë. Janë bërë ndryshimet e nevojshme në sistemin e NE lidhur me deklaratimet 3 mujore, vizitat në shtëpi si dhe afatin e vlefshmërisë për statusin e jetimit.
- **Në zbatim të VKM nr. 254, datë 27.03.2020**, "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, ndihmës ekonomike e të pagesës të së ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, të shpallur si pasojë e Covid-19" Këshilli i Ministrave parashikoi dhënien e një një pagese shtesë për individët që përfitojnë pagesë të ndihmës ekonomike.

Janë udhëzuar Drejtoritë Rajonale lidhur me procedurën për shpërndajen e pagesës së dyfishimit të ndihmës ekonomike. Pagesa e ndihmës ekonomike për subjektet përfituese, sipas legjislacionit në fuqi për ndihmën ekonomike, për familjet dhe individët që rezultojnë përfitues të ndihmës ekonomike ose kanë aplikuar për të përpara datës 10 mars 2020, ishte sa dyfishi i shumës së llogaritur sipas strukturës së familjes apo kategorive të veçanta përfituese të cilët trajtohen me masë fikse të ndihmës ekonomike.

Në zbatim të vendimit të sipërpërmendur Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror miratoi Urdhrin nr. 92/4, datë 27.03.2020 "Për përfitimin e masës së ndihmës ekonomike për familjet/individët në nevojë si pasojë e epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-19", për të detajuar procedurat e dhënies së përfitimit. Sipas këtij Urdhri Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dërgojnë pranë njësisve vendore listat e përfituesve të muajit Mars 2020 me shumat përkatëse për të hartuar borderotë.

Për periudhën prill, maj dhe qershor kanë përfituar dyfishim të masës së ndihmës ekonomike 63.510 familje (familje përfituese me sistemin e pikëzimit+familje të trajtuara me fondin 6%) me fond 938,497,000 lekë.

- **Në zbatim të vendimit nr. 341, datë 23.4.2020** "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 305, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e covid-19", Këshilli



i Ministrave vendosi dhënien e një ndihme financiare prej 16.000 (gjashtëmbëdhjetë mijë) lekësh për aplikuesit e ndihmës ekonomike, të cilët rezultojnë aplikues që nga muaji Korrik 2019 e deri në muajin Prill 2020, të cilët nuk kishin përfituar ndihmë ekonomike dhe, në çastin e hyrjes në fuqi të vendimit, ende nuk përfitonin ndihmë ekonomike nga sistemi i pikëzimit dhe as nga fondi 6 % i akorduar bashkive.

Nga kjo pagesë u përjashtuan rastet që nuk kishin përfituar nga skema e ndihmës ekonomike pas aplikimit, për shkak të refuzimit në përputhje me nenin 15, të ligjit nr. 57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”. Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dërguan pranë bashkive, listat e familjeve të cilat nuk ishin përzgjedhur përfituese të skemës së ndihmës ekonomike. Bashkitë realizuan njoftimin e familjeve për marrjen e përfitimit dhe ekzekutuan pagesat për ndihmën financiare.

Në bazë të pikës 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 305/2020, të ndryshuar, pika 8, u trajtuan me ndihmë financiare prej 16.000 lekë, 4,524 familje aplikuese të ndihmës ekonomike të cilat kishin aplikuar për periudhën korrik 2019- prill 2020, por nuk kishin përfituar nga sistemi i pikëzimit dhe fondi deri në 6%, sipas aneksit nr. 4 bashkëlidhur, me të dhëna të gjeneruara nga raporte të përftuara përmes të dhënave që disponon Regjistri Elektronik Kombëtar i Ndihmës Ekonomike.

- **Në zbatim të Vendimit Nr. 236, datë 19.3.2020** “Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga Covid-19” u përcaktua që në kushtet e epidemisë të ofrohet asistencë në banesë ndaj shtresave në nevojë nga strukturat shtetërore. Ofrimi i asistencës, do të përfshinte edhe dërgimin e produkteve ushqimore. Prefekturat, bashkitë, Shërbimi Social Shtetëror dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore përpiluan listat e subjekteve përfituese, brenda 3 (tre) ditëve dhe ia dërguan Komisionit Qendror për Ofrimin e Asistencës. Pas verifikimit të listave nga Komisioni Qendror për Ofrimin e Asistencës, u bënë rakordimet përkatëse dhe këto lista iu konfirmuan prefektëve të qarqeve, kryetarëve të bashkive, Shërbimit Social Shtetëror dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për të vijuar me shpërndarjen e produkteve ushqimore.

Në zbatim të pikës 4 të vendimit Nr. 236, datë 19.03.2020 janë trajtuar me paketa ushqimore në 61 bashki të vendit, 64,000 familje përfituese të ndihmës ekonomike për periudhat mars, prill, maj 2020.

OBJEKTIV II

KONSOLIDIMI I SKEMËS SË NDIHMËS EKONOMIKE ME ANË TË MIRËADMINISTRIMIT TË REGJISTRIT ELEKTRONIK KOMBËTAR DHE SISTEMIT TË PIKËZIMIT

2.1 Mirëadministrimi i Regjistrit Elektronik të Ndihmës ekonomike duke integruar për fondin deri në 6%.



- Vërtetimi Elektronik për NE dhe PAK në shërbimin e-albania. Në muajin prill është hartuar dhe dërguar formati lidhur me vërtetimin elektronik të NE dhe PAK, pjesë e portalit e-albania. Në muajin maj-qershor është testuar me përfituesit dhe ky shërbim është bërë aktiv në qershor 2020.
- Ndërtimi i workflow-t dhe shtimi në sistemin e NE i procesit të rekomandimit dhe konfirmimit të familjeve në fondin 6% duke bërë të mundur llogaritjen e shumave sipas strukturës së familjes dhe shtimin e kompensimit të energjisë elektrike në momentin e rekomandimit të familjes.
- Shtim raporte respektive për fondin 6% sipas statusit, rekomanduar, përfitues, refuzuar si dhe përmirësimi i tyre.
- Takim me Drejtoritë Rajonale në lidhje me shtimin e modulit të fondit 6% në sistemin e NE dhe ndjekja e problematikave të tyre në vazhdim në lidhje me fondin 6%. Fillimisht sidomos muajt janar dhe shkurt kanë pasur të dhëna jo plotësisht të sakta për arsye se administratorët mund të mos kenë hedhur të gjitha familjet përfituese të fondit 6% në sistem, por të dhënat kanë ardhur duke u përmirësuar.
- Shtim raporti në sistem në lidhje me arsyet e çaktivizimit dhe anëtarët e çaktivizuar.
- Shtim verifikimi automatik me DPGJC në lidhje me strukturën e familjes, duke shfaqur si mospërputhje aplikimet që kanë ndryshime në përbërje nga gjendja aktuale në DPGJC.
- Përmirësim i raportit të pagesave ekstra, në lidhje me numrin e familjeve që përfitojnë kompensimin e energjisë elektrike dhe numrin e fëmijëve që përfitojnë pagesën në raport me numrin e fëmijëve të familjes.
- Përmirësim në formatin e projektit-raportit dhe raportit përfundimtar, në modulën e kontrollit.
- Përmirësim në raportin “anëtarë në moshë aktive të familjeve përfitues, familje aplikuese” etj.
- Ndjekja e problematikave teknike të sistemit të NE nëpërmjet portalit Jira.

2.2 Monitorim i Drejtorive Rajonale lidhur me objektivin për orientimin drejt tregut të punës si dhe punësimet e anëtarëve në moshë aktive pune të përfituesve të NE-së.

Për shkak të situatës Covid-19 në 2020 ka një ulje të numrit të anëtarëve të familjeve të NE të orientuar drejt punësimit, 669 të punësuar dhe 153 drejt formimit profesional krahasuar me vitin 2019 ku kanë qenë **1324 anëtarë të punësuar të familjeve të NE dhe 439 anëtarë janë orientuar drejt kursit të formimit profesional dhe në vitin 2018** ku të punësuar kanë qenë 2591 individë dhe 805 të orientuar drejt formimit profesional.

Të dhënat janë të raportuara nga Drejtoritë Rajonale në bashkëpunim me Zyrat e Punës në kuadër të planit operacional për punësimin e anëtarëve aktivë në moshë pune të skemës së Ndhmës Ekonomike 2019-2020.

Muaji	Punësuar	Formim Profesional
Janar	206	100
Shkurt	82	41



Mars	16	2
Prill	22	0
Maj	18	0
Qershor	44	0
Korrik	75	0
Gusht	95	0
Shtator	51	1
Tetor	19	5
Nëntor	32	4
Dhjetor	9	0
Total	669	153

OBJEKTIV III

ZBATIMI I LEGJISLACIONIT PËR NDIHMËN EKONOMIKE DHE PAGESAT PAK NËPËRMJET KONTROLLEVE TË USHTRUARA PRANË NJËSIVE VENDORE

Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK dhe 12 Drejtoritë Rajonale kanë hartuar planin vjetor të kontrolleve për ndihmën ekonomike për vitin 2020 nëpërmjet modulit të kontrollit në sistem dhe kontrolle për zbatimin e legjislacionit të pagesave të PAK dhe invalidëve të punës. Për shkak të pandemisë kontrollet në njësitë vendore në periudhën mars-qershor janë ndërprerë.

Për vitin 2020 janë kontrolluar 134 njësi vendore dhe janë konstatuar 1275 familje që kanë përfituar në kundërshtim me legjislacionin, me dëm ekonomik 7.315.636 lekë dhe 285 PAK dhe invalidë pune me dëm ekonomik 4.862.756 lekë. Janë propozuar 109 masa, 76 raste shpërblim dëmi, 22 masa administrative dhe 11 raste gjobe.

Qarqet Dibër dhe Shkodër janë qarqet në të cilat janë konstatuar problematikat më së shumti me familjet të cilat kanë përfituar në kundërshtim me legjislacionin që lidhen me:

- Pagesë e padrejtë në strukturën e familjes në rast se ka anëtarë të familjes PAK (nuk checkohet në sistem);
- Pagesa energjie elektrike me mungesë të librezës së energjisë elektrike;
- Mos-firmosje të deklaratave 3-mujore nga të gjithë anëtarët madhorë të familjes;
- Familje që trajtohen me fondin deri në 6% pa përmbushur kriteret.



DR RAJONALE	Nj Ad të kontrolluara	Nr. Verifikimeve social ekonomike	Mashttrim		Gabim		Dëmi Ekonomik		Nr. PAK me probleme	Dëmi Ekonomik	Nr. Invalid pune me probleme	Dëmi Ekonomik	Totali i dëmit NE+PAK	Masat Administrative
			Nr. Fam	Fond	Nr. Fam	Fond	Nr. Fam	Fond						
Tiranë	9	36			9	296768	9	296768			7	19800	316568	5-Shpërblim Dëmi
Durrës	6	92			8	57910	8	57910	24	1236330	27	316200	1610440	9 Masa, 3-Masa Disiplinore, 1-Gjobë 50000 lekë, 5-Shpërblim Dëmi
Elbasan	16	148	36	553832			36	553832	13	73725	9	33000	660557	12-Shpërblim dëmi
Korçë	12	141			47	361596	47	361596	1	10540	6	23100	395236	9 -Shpërblim Dëmi
Vlorë	12	56			10	158056	10	158056	3	38956	10	146100	343112	3-Masa Disiplinore
Lezhë	10	108			39	227912	39	227912			12	99000	326912	7 Masa, 5-Shpërblim Dëmi, 1-Mase Disiplinore 1-Gjobë 50000 leke Administratori
Gjirokastrë	11	15	2	302040	9	388936	11	690976	4	442712	1	6600	1140288	9-Shpërblim Dëmi
Shkodër	19	31			227	2495860	227	2495860	69	1539704	21	118800	4154364	37-Masa, 18-Shpërblim Dëmi, 11- Masa Disiplinore, 8-Gjoba
Fier	9	24			6	110368	6	110368	1	14140			124508	
Kukës	8	35	16	294040	43	584036	59	878076	7	83858			961934	4-Shpërblim Dëmi
Dibër	16	200			785	943529	785	943529	46	420079	21	190900	1554508	13-Masa, 9-Shpërblim Dëmi, 4-Masa Disiplinore
Berat	6	87	10	124854	28	415899	38	540753	1	42612	2	6600	589965	1-Gjobë 50000 leke Administratorit.
Total	134	973	64	1274766	1211	6040870	1275	7315636	169	3902656	116	960100	12178392	109 Masa gjithsej, 76-Shpërblim Dëmi, 22-Masë Disiplinore, 11-Gjobë 50000 leke

3.1 Kontrollle të kryera nga Drejtoria e Kontrollit të Pagesës së NE dhe PAK

3.1.1 Sektori NE

Gjatë vitit 2020 janë kontrolluar 4 Drejtori Rajonale. Drejtoria Rajonale Vlorë është kontrolluar në muajin Shkurt ku kontrolli ka qënë i plotë në bazë sistemi si dhe në terren pranë kësaj drejtorie. Në periudhën mars-qershor 2020 nuk janë kryer kontrollle për shkak të situatës së Covid- 19. Në muajin korrik është vijuar me kontrollin e Drejtorisë Rajonale Korçë, në shtator me kontrollin e Drejtorisë Rajonale Dibër, në Nëntor me kontrollin e Drejtorisë Rajonale Kukës, kontrollle të cilat janë kryer mbi bazë sistemi si dhe duke komunikuar në rrugë elektronike me specialistët e Drejtorisë Rajonale.

Nga kontrolli i ushtruar në 4 Drejtoritë Rajonale janë konstatuar problematikat si më poshtë vijon:

- Plani vjetor nuk është zbatuar 100% për vitin 2020 nga Drejtoritë Rajonale për shkak të situatës së pandemisë së Covid- 19.
- Nga kontrolli i zbatimit të detyrave të lëna konstatohet se detyrat e lëna nuk zbatohen plotësisht, kryesisht detyrat e lëna lidhur me shpërblimin e dëmit ekonomik, për familjet që e kanë përfituar ndihmën ekonomike në kundërshtim me ligjin. Arkëtimet janë në nivel të ulët dhe nuk mbahen të dhëna të sakta nga Drejtoritë Rajonale lidhur me arkëtimet.
- Nga kontrolli rezultoi se verifikimet në familje nuk janë kryer brenda muajit të parë të aplikimit për familjet që aplikojnë për herë të parë si dhe dy herë në vit për familjet përfituese me ndihmë ekonomike. Nga kontrolli u identifikuan familje të cilat, gjatë vizitave në banesë të kryer nga administratori rezultonin me ndryshime nga deklaratimet e tyre, mospërputhjet nga vizita në shtëpi nuk janë trajtuar dhe nuk është marrë vendimi për largimin nga skema e ndihmës ekonomike, kjo në kundërshtim në me VKM-në Nr.597 datë 4.09.2019, Kreu II, pika 11, gërma (ç)(ç) *fsheh informacionin apo kryen deklaratim të rremë.*
- Gjithashtu janë evidentuar raste që nuk është plotësuar saktë formulari i vizitës në familje sipas të gjitha rubrikave përkatëse dhe ka pasur probleme me hedhjen në sistem. Në rastet kur ka ndryshime duhet të chekohet pyetja “po” ka ndryshime nga deklarimi gjatë hedhjes në sistem të vizitës në familje dhe të pasqyrohen të gjitha ndryshimet me qartësi dhe korrektësi.
- Lidhur me verifikimet manuale u konstatua se listat dërgoheshin pas datës 10 të çdo muaji nga Drejtoria Rajonale. Jo të gjitha institucionet të cilave ju dërgohej lista për konfirmim kthenin përgjigje dhe disa nga përgjigjet ishin formale. Agjensia Shtetërore e Kadastrës, Zyrtarë Vendore me anë të shkresave zyrtare kanë vënë në dijeni Drejtoritë Rajonale se informacioni i kërkuar do të jepet kundrejt tarifave përkatëse dhe nuk kanë kthyer përgjigje.
- Në Qarqet Dibër, Kukës dhe Korçë janë trajtuar me ndihmë ekonomike familje të cilat kanë një apo më shumë të punësuar në sektorin privat si dhe në atë publik, të cilët i kanë deklaruar të ardhurat nga punësimi. Të ardhurat nga punësimi variojnë nga 30.000 lekë që është aktualisht paga minimale në shkallë vendi deri në 80.000 lekë në muaj. Këto familje nuk janë refuzuar nga skema e ndihmës ekonomike nga ana e Drejtorisë Rajonale me arsyen se kanë deklaruar të ardhurat nga punësimi dhe nuk përbëjnë deklaratim të rremë.

- Janë konstatuar familje të cilat kanë pasur më shumë se një mjet në pronësi dhe nuk është bërë refuzimi i tyre nga skema e ndihmës ekonomike me arsyen se kanë deklaruar mjet në formularin e aplikimit.
- Për Qarqet Dibër dhe Kukës është konstatuar se, nuk është zbatuar me saktësi procedura e vendimarrjes ku parashikohet se specialisti i Drejtorisë Rajonale (Verifikuesi) pasi përfundon procesi i verifikimeve automatike dhe manuale kryen konfirmimin e verifikimeve, trajton përgjigjet e ardhura duke i konsideruar shkelje ose jo, plotëson rubrikën e komenteve sipas rastit dhe njofton vendimmarrësin për të vazhduar me procesin e vendimarrjes.
- Në këto dy Qarqe rezulton se, jo në të gjitha rastet është zbatuar afati i penalitetit për familjet që janë refuzuar nga skema e ndihmës ekonomike për dekarim të rremë, pasi janë lejuar të riaplikojnë gjatë periudhës së penalitetit nga administratorët shoqëror dhe nuk janë verifikuar nga ana e Drejtorisë Rajonale gjatë vendimarrjes.
- Për Qarkun Dibër nga kontrolli me përzgjedhje i verifikimeve automatike janë konstatuar 25 familje me deklaram të rremë të cilat nuk janë refuzuar nga skema e ndihmës ekonomike nga ana e Drejtorisë Rajonale Dibër në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 57, datë 18.07.2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, neni 15. Dëmi ekonomik i shkaktuar është 1.696.668 lekë.
- Për Qarkun Kukës janë konstatuar 34 familje me deklaram të rremë të cilat nuk janë refuzuar nga skema e ndihmës ekonomike nga ana e Drejtorisë Rajonale Kukës në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 57, datë 18.07.2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, neni 15. Dëmi ekonomik i shkaktuar është 1.913.676 lekë.
- Specialistët e Drejtorisë Rajonale Dibër kanë zbatuar pjesërisht detyrat dhe përgjegjësitë e strukturës kontrolluese në përputhje me përcaktimet e bëra në Metodologjinë e kontrollit në pikën 1.2.2, në zbatim të VKM nr. 566, datë 29.09.2018, “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të veprimtarisë e të zbatimit të legjislacionit për ndihmën ekonomike dhe aftësinë e kufizuar në strukturat e varësisë së Shërbimit Social Shtetëror dhe pranë njësive të vetëqeverisjes vendore” si dhe Udhëzimi nr.714 datë 11.10.2018, “Për metodologjinë e kontrollit të pagesave të ndihmës ekonomike”.
- Një nga problematikat e konstatuara gjatë kontrolleve është moszbatimi i detyrave të lëna lidhur me shpërbimin e dëmit për familjet që e kanë përfituar ndihmën ekonomike në kundërshtim me ligjin si edhe mos mbajtja e të dhënave të sakta nga ana e Drejtorive Rajonale lidhur me arkëtimet.

3.1.2 Sektori i PAK

Në Gusht 2020 është plotësuar Sektori i PAK me pozicionin e përgjegjës të sektorit, por ende janë vakante dy pozicionet e tjera (mjek dhe IT). Gjatë muajit tetor në kuadër të rishikimit të metodologjisë së kontrollit të aftësisë së kufizuar të vlerësimit bio-psiko-social u realizua nga kompania një diskutim lidhur me çështjet se si duhet të fokusohet kontrolli. Në muajt tetor-nëntor u zhvillua kontroll tematik në:

- Në Komisionin Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar pranë Dipancerisë ku marrin shërbim njësitë administrative Kamëz, Paskuqan, Prezë dhe Vorë;
- Në Komisionin Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar pranë Poliklinikës së Specialiteteve nr.3 ku marrin shërbim njësitë administrative Bërzhitë, Petrelë, Njësia 8, Njësia 9, Njësia 10 dhe Njësia 11.

Nga kontrolli rezultoi se:

- Ka ndryshime të përcaktimit të nivelit të dëmtimit midis mjekut specialist dhe Komisionit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar, në shumë nga këto raste të verifikuara niveli i dëmtimit i përcaktuar nga komisioni shumëdisiplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar është më i ulët se niveli i dëmtimit të përcaktuar nga mjeku specialist e verifikuar kjo dhe nga regjistri elektronik i PAK.
- Nisur nga këto konkluzione janë bërë propozime përkatëse dhe janë dërguar në qendrat shëndetësore përkatëse dhe për dijeni në MSHMS.
- Mjeku specialist dhe mjeku i familjes duhet të mbështesë nivelin e vështirësisë në bazë të ekzaminimeve, konsultave dhe kartelës së ndjekjes dhe gjithashtu të shpjegojë klinikën në dëmtimin e përcaktuar në formularin e aplikimit sipas diagnozës përkatëse.
- Mjeku specialist duhet të përcaktojë diagnozën sipas udhëzuesit bio- psiko- social dhe të pajisë pacientin me ekzaminime sipas udhëzuesit përkatës për të rritur dhe për fëmijë, si dhe konsulta apo ekzaminime shtesë kërkuar nga komisioni multidisiplinor për të bërë një vlerësim më të saktë mbi gjendjen e tij.

II. DREJTORIA E KOMISIONIMIT TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Në këtë fushë të mbrojtjes sociale konsiderojmë arritje ndryshimet që kanë ndodhur gjatë vitit 2020 janë:

- Ngritja e 4 komisioneve të Nivelit të Parë në Tiranë për vlerësimin e dosjeve në nivelin Qendor dhe jo më në nivel Rajonal (nga 11 komisione në 4 të tilla).
- Shmangie të konfliktit të interesit dhe një vlerësim më të specializuar të dosjeve.
- Vlerësimi i dosjeve bëhet më i drejtë pasi komisionet janë të ndara sipas specialiteteve dhe jo më si një komision që i shqyrtonte të gjitha dosjet së bashku.
- Përgatitjet për shtrirjen e modelit bio-psiko-social në Qarkun Elbasan dhe Durrës.

Sot përfitojnë Pagesë për Aftësinë e Kufizuar 73.200 persona, prej të cilëve 19.606 me kujdestar.

Tabela 1: Numri i personave pjesë e skemës së AK 2018-2020

	2018	2019	2020
Individë	69.743	72.183	73.200
Kujdestar	19.288	19.769	19.606

Tabela 2: Përfituesit e PAK në qarqe 2018 2020

Qarku	2018	2019	2020
Berat	3,792	3,857	3.655
Dibër	3,684	3,650	3.630
Durrës	5,944	6,326	6.416
Elbasan	11,368	12,264	12.810
Fier	7,765	7,657	8.252
Gjirokastrë	2,254	2,321	2.330
Korçë	6,565	6,643	6.653
Kukës	2,318	2,480	2.529
Lezhë	4,155	4,412	4.474
Shkodër	5,560	5,711	5.500
Tiranë	11,751	12,288	12.324
Vlorë	4,587	4,574	4.627
TOTAL	69,743	72,183	73.200

Tabela 3: Përfitues AK sipas sëmudshmërisë 2018-2020

Sëmudnja	2018	2019	2020
Mendor/fizike	50,869	53,050	54,466
Me kujdestari	9,694	9,945	10,047
Paratetraplegjikë	6,604	6,689	6,549

Me kujdestari	6,452	6,634	6,457
Verbëri	2,270	12,444	12,185
Me kujdestari	3,142	3,190	3,102

Aktiviteti kryesor i kësaj drejtorie është ndjekja e ecurisë së komisionimeve të PAK në KMCAP-et e Nivelit të Parë, komisionimi në KMCAP Epror i personave që ankimojnë vendimet e KMCAP-eve të Nivelit të Parë, si dhe komisionimi i sistemit Bio-Psiko-Social për Tiranën.

OBJEKTIVI I

REZULTATET E KOMISIONIMEVE TË PAK

1.1 KMCAP Epror

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020 kanë ankimuar vendimet e KMCAP-eve Rajonalë dhe janë komisionuar dhe vlerësuar në KMCAP Epror 1.028 individë, prej të cilëve janë larguar nga skema e PAK 424 individë (pa grup) ndërsa 604 individë vijnë përfitimin nga skema e PAK.

Tabela 4: Të dhënat e detajuara sipas secilit prej KMCAP-ve Epror

Viti	Komisionuar/Shëndeti mendor	Përfitues	Jopërfitues
2018	497	354 (71%)	143 (29%)
2019	513	362 (71%)	151 (29%)
2020	215	120 (6%)	95 (44%)

Viti	Komisionuar/Sëmundje e Përgjithshme	Përfitues	Jopërfitues
2018	1.016	354 (71%)	143 (29%)
2019	2.048	1.229 (60%)	819 (40%)
2020	512	279 (55%)	233 (45%)

Viti	Komisionuar/Para-Tetraplegji	Përfitues	Jopërfitues
2018	216	132 (61%)	64 (30%)
2019	193	129 (64%)	64 (32%)
2020	101	46 (46%)	55 (54%)

Viti	Komisionuar/Verbëri	Përfitues	Jopërfitues
2018	691	552 (80%)	139 (20%)
2019	978	650 (66%)	328 (34%)
2020	200	159 (79%)	41 (21%)

Nga analiza e tabelës për komisionimeve në KMCAP Epror të sëmundjeve të përgjithshme dilet në përfundimin se gjatë vitit 2020 ka një ulje të numrit të komisionimeve, por një rritje të numrit të personave që janë vlerësuar jo përfitues.

1.2 Kmcap-et e nivelit të parë

Drejtoria e Komisionimit të PAK ndjek në vijimësi dinamikën e vlerësimeve të bëra në KMCAP-et e nivelit të parë, në mënyrë që të analizojë riskun dhe të alertojë mjekët e komisioneve të nivelit të parë kur vërehet rritje e pajustificuar e skemës.

Sipas të dhënave të dërguara nga mjekët e nivelit të parë të pasqyruar në tabelat mujore të komisionimeve për çdo muaj për vitin 2020, janë komisionuar gjithsej 10,522 persona nga të cilët janë vlerësuar 7,860 përfitues dhe 2,662 jo përfitues.

Gjatë vitit 2020, KMPV sipas Vkm nr. 618, e ndryshuar dhe të rregullores miratuar me urdhrin e ministrit nr. 47/1 dt. 11.01.2018, KMPV-ja është zhvilluar me dosje pa praninë e personit. Gjatë periudhës 2020, Komisioni Mjekësor i Përcaktimit të Verbërisë (KMPV) ka komisionuar dhe vlerësuar 1.661 persona, nga të cilët 1.575 janë përfitues dhe 87 individë jopërfitues.

Tabela 5: Krahasim i komisioneve ndër vite

Viti	KMPV	JoPërfitues	Përfitues
2018	3,989	1,037	2,952
2019	3,432	229	2,236
2020	1,661	87	1,575

Komisioni	Total	JoPërfitues	Përfitues
Shëndet Mendor	1.589	29	1.560
Onkologji/Kirurgji/Ortopedi	1.568	529	976
Paraplegji	3573	1.480	2.093
Sëmundje Interne	2.131	475	1.656

Ministria e Shëndetësisë dhe Shërbimi Social Shtetëror ngritën grupin task-force për dosjet e komisionuara për herë të parë nga janari 2018 deri më dhjetor 2020.

Raportim për kontrollin e dosjeve nga Task Forca deri më 31.12.2020

Nr.	Bashkia	Numri i dosjeve në total	Numri i dosjeve të kontrolluara	Përqindja ndaj totalit	Probleme me elemente mjeksore		Probleme me dokumentacionin		Dërgohen për KMCAP Nivelit I	Nr i dosjeve të rivlersuar a në KMCAP Epror	Vizita në familje	Konflikt interesi	Shenim
					Nr i dosjeve	% ndaj totalit	Nr i dosjeve	% ndaj totalit					
1	Shkodër	5,638	3,864	69	429	8	3	0	15	-	2	322	
2	Berat	325	325	100	-	0	4	1	60	-	-	0	Ka përfunduar kontrollin e dosjeve
3	Korçë	713	713	100	-	0	3	0	-	1	-	37	Ka përfunduar kontrollin e dosjeve
4	Lezhë	522	232	44	39	7	-	0	8	-	-	15	Për shkak të covid-19 nuk ka pasur kontrolle qe nga data 14.12.2020
5	Kukës	2,093	253	12	-	-	8	0	8	-	7	-	Nuk ka pasur kontrolle gjate muajve Nentor, Dhjetor si pasoje e Covid-19
6	Tiranë	3,645	3,645	100	-	0	-	0	-	-	-	134	Ka përfunduar kontrollin e dosjeve
7	Fier	1,876	564	30	-	0	79	4	-	-	-	43	Ka përfunduar kontrollin e dosjeve.
8	Gjirokastër	975	975	100	13	1	-	0	13	-	-	-	Ka përfunduar kontrollin e dosjeve.
9	Durrës	1,113	648	58	5	0	-	0	-	-	-	74	
10	Vlorë	697	550	79	40	6	13	2	3	144	-	-	Ka përfunduar kontrollin e dosjeve
11	Dibër	524	524	100	78	15	15	3	109	-	-	0	Ka përfunduar kontrollin e dosjeve
12	Elbasan	7,566	6,950	92	582	8	113	1	603	27	-	-	
	Totali	25,687	19,243	75	1,186	5	238	1	819	172	9	625	



OBJEKTIVI II

PILOTIMI I MODELI I RI TË VLERËSIMIT BIO-PSIKO-SOCIAL DHE I SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË INFORMACIONIT PËR PROGRAMIN E PAGESËS SË AFTËSISË SË KUFIZUAR

Nga data 2 dhjetor 2019 është i shtrirë në të gjithë qytetin e Tiranës modeli i ri të vlerësimit Bio-Psiko-Social. Janë 5 (pesë) komisione multidisiplinare, të vendosura brenda qendrave shëndetësore të Tiranës, mbulojnë bashkitë Tiranë, Kamëz dhe Vorë përkatësisht pranë Dispancerisë, Qendrës shëndetësore nr. 6 dhe nr. 10, Poliklinika e specialiteteve nr. 3 dhe nr.1. Një komision pranë spitalit Kavajë mbulon bashkitë Kavajë dhe Rrogozhinë.

Viti	Komisioni bio-psiko-social Tiranë	JoPërfitues	Përfitues
2020	5,136	606	4,530

Në muajin dhjetor 2020 ka nisur komisioni Epror i shqyrtimit të ankesave të nivelit të parë të modelit Bio-Psiko-social i cili funksionon pranë Shërbimit Social Shetëror.

Gjatë vitit 2020 kanë vijuar përgatitjet për shtrirjen e modelit bio-psiko-social në Qarkun Elbasan dhe Durrës. Për këtë:

- Janë bërë trajnimet e administratorëve shoqëror nga SHSSH dhe MSHMS;
- Janë bërë trajnimet e mjekëve të familjes dhe mjekëve specialistë nga SHSSH dhe MSHMS;
- Eshtë bërë përgatitja e ambienteve ku do të zhvillojnë aktivitetin komisionet shumë disiplinore nga ana e infrastrukturës, (zyra, mobilim si dhe materialeve të punës, kompjuterat etj).
- Janë përgatitur hartat e shpërndarjes së njësive administrative sipas komisioneve.



III. DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka në fokus të punës së saj zhvillimin e shërbimeve shoqërore sipas legjislacionit përkatës. Kjo drejtori për vitin 2020 ka hartuar planin e veprimit me objektiva të matshme. Qëllimi i këtij plani orientues dhe zhvillues është rritja e cilësisë së shërbimeve sociale të ofruara për grupet vulnerabël në zbatim të strategjisë së mbrojtjes sociale.

OBJEKTIVI I

ZHVILLIMI I SHËRBIMEVE SHOQËRORE SIPAS STRATEGJISË KOMBËTARE

Për realizimin e këtij objekti u realizuan aktivitetet e mëposhtme:

- Takime me punonjësit e Drejtorive Sociale të Bashkive dhe Drejtorive Rajonale të SHSSH për hartimin e planeve sociale dhe zbatimin e legjislacionit në fushën sociale;
- Janë realizuar raporte dhe plane veprimi të ndryshme sipas Strategjive përkatëse:
 - *Raportimi mbi realizimin e objektivave dhe detyrave të përcaktuara në planin e veprimit të strategjisë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve;*
 - *Raportimi 3- vjecar në INSTAT për regjistrin elektronik të të dhënave për fëmijët në nivel kombëtar;*
 - *Raporti vjetor mbi luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore;*
 - *Hartimi i protokolleve për funksionimin aktivitetit të IPSH-ve publike dhe jopublike në situatën e pandemisë shkaktuar nga Covid-19.*
- Bazuar në strategjinë kombëtare për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm në nëntor të viti 2020 u ngrit Qendra Pritëse e Trajtimit të Rasteve të Rikthyer nga Zonat e Luftës Siria dhe Iraku. Shërbimet që ofron qendra janë trajtimet e specializuara për traumat dhe lehtësimi për jetesë të pavarur dhe ndërgjigjegjësimit për të jetuar në komunitet.
- Ndjekja dhe Mirëadministrimi i Regjistrat Elektronik të Shërbimeve Shoqërore.
- Drejtoria e Shërbimeve Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe 5 OJF ishte pjesë e zbatimit të Strategjisë së Deinstitutionalizimit dhe koordinimit të punës për vlerësimin e fëmijëve në IPSH dhe me bashkitë për fuqizimin e familjeve biologjike që kanë fëmijët në institucione. Ka përfunduar faza e parë e projektit ku janë bërë vlerësimet e fëmijëve dhe familjeve potenciale për rikthim në familje. Potencial për rikthim në familje ishin 25 raste. Gjithashtu dhe vlerësimi i shërbimeve të ofruara për fëmijë për transformimin e qendrave për fëmijë në Vlorë dhe Korçë.
- Është realizuar mbledhja dhe përpunimi i të dhënave të shërbimeve shoqërore për çdo bashki, në bashkëpunim me punonjësin social të DRSHSSH për përditësimin e hartës së shërbimeve sociale në nivel Bashki/Qark në lidhje me IPSH-të e fëmijëve, të moshuarve, të personave me aftësi të kufizuara, të trafikimit, të dhunës, komunitare dhe të emergjencave.



- Nga të dhënat e Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror raportohet se janë 228 qendra të cilat ofrojnë shërbime sociale për kategori të ndryshme. Gjatë vitit 2020 janë hapur 5 shërbime të reja sociale.

OBJEKTIVI II

PËRKUJDESJE SOCIALE ME STANDARDE TË PËRMBUSHURA

DSHS në SHSSH për realizimin e këtij objekti ka planifikuar dhe realizuar aktivitetet si më poshtë:

- ✓ Monitorimi i IPSH-ve sipas kalendarit të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm;
- ✓ Përpunimi i të dhënave statistikore 4 mujore të IPSH dhe analiza e dinamikës së përfituesve;
- ✓ Komisionim i kujdesshëm për të gjitha tipologjitë e shërbimit në IPSH;
- ✓ Bashkëpunim me aktorët lokalë për menaxhimin e rasteve me objektiv parandalimi i institucionalizimit dhe kthim në familjen biologjike/kujdestare/birësuese;
- ✓ Trajnimi i personelit të njëjësive të qeverisjes vendore për ofrimin e shërbimeve shoqërore.
- ✓ Terapi psiko - sociale on-line në IPSH për reduktimin e ngarkesës emocionale gjatë periudhës së karantinës për shkak të pandemisë, e kryer nga grupi i punës së ngritur me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm.
- ✓

Të dhënat e përfituesve në Institucionet Rezidenciale për personat në nevojë

Në fund të vitit 2020, në 30 institucionet të përkujdesit shoqëror publike, rezidenciale dhe ditore kanë marrë shërbim 1141 persona krahasuar me vitin 2019 numri i përfituesve në IPSH, i cili ka qenë 1188 persona (IPSh rezidenciale, ditore, dhe individë në QKTE). Nga statistikat rezulton se numri i përfituesve në IPSH ka rënie si rrjedhojë e pandemisë së Covid-19 dhe ofrimit të shërbimeve të tjera alternative.

Tabela 1: Numri i përfituesve në Ipsh rezidenciale publike në vite

Nr. i përfituesve	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Totali i personave PAK në IPSH	233	228	201	189	222	214	194	194
Totali i fëmijëve në IPSh publike	306	246	223	179	193	213	218	229
Totali i personave të moshuar në IPSh	298	290	279	236	280	304	318	301
QKPVT	26	42	33	30	26	15	18	10
QKTVDHF	72	84	75	95	85	90	91	60(34)

QKTE	52	53	41	47	45	44	42	gra dhe 36 fëmijë)
				familje/ 195 persona	familje/ 186 persona	familje/1 75 persona	familje dhe 166 persona	47 familje dhe 174 banorë.





Tabela 2: Numri i përfituesve që marrin shërbim ditor

IPSH Ditore	Viti 2013	viti 2015	viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
PAK DITOR	98	85	86	62	65	60	59
FEMIJE DITOR	50	47	56	47	34	57	34
MOSHUAR	83	82	78	76	76	66	80
Total	231	214	220	185	175	202	173



Gjatë vitit 2020 nga IPSH-të publike për fëmijë janë **rikthyer në familje biologjike 12 fëmijë dhe 3 persona me AK. Janë birësuar 27 fëmijë nga IPSH publike.**

Ulja e numrit të fëmijëve të rikthyer në familje biologjike nga IPSH publike vjen si rrjedhojë e sistemimit të fëmijëve si rast emergjente dhe kohëzgjatja e procesit gjyqësor për t'u shprehur me vendim për qëndrimin apo rikthimin në familje të fëmijëve të pranuar si raste emergjente dhe njëkohësisht për mosfuqizimin e familjes.


Gjatë vitit 2020 janë pranuar në IPSH-të rezidenciale, sipas mekanizmit të mbrojtjes së fëmijës nga ekipet multidisciplinare të ngritura nëpër Bashki, 25 raste emergjente në bazë të ligjit nr.18/2017 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Republikën e Shqipërisë”, ndërsa gjatë vitit 2019 janë vendosur në IPSH - të publike rreth 49 fëmijë. SHSSH ka ndjekur 18 raste fëmijësh gjatë vitit 2020 në procese gjyqësore.

Në 6 qendrat e zhvillimit (rezidenciale) për PAK, gjatë vitit 2020 janë kthyer në familje 3 persona me aftësi të kufizuar, ndërkohë që në vitin 2019 janë kthyer në familje 12 persona me aftësi të kufizuar.


Në vitin 2020, në QKPVDHF kanë marrë shërbim 60 raste viktime të dhunës nga këto 24 gra dhe 36 fëmijë, prej të cilave 47 raste të reja (19 gra dhe 32 fëmijë). Janë larguar nga qendra 51 banorë (19 gra dhe 32 fëmijë).

Gjatë vitit 2020 në Shtëpitë e të Moshuarve janë sistemuar 42 të moshuar në 120 kërkesa për sistemim, ndërkohë që numri i sistemimit të të moshuarve për vitin 2019 ka qenë 66 të moshuar në 174 kërkesa. Këto të dhëna tregojnë se dhe pse numri i kërkesave është në rritje numri i sistemimeve në IPSH rezidenciale për të moshuar është zvogëluar pasi rastet janë orientuar drejt shërbimeve alternative.

Grafiku nr 3. Rikthimet në familje, birësimet dhe kujdestaria në familje e femijeve në IPSH-të publike



Grafiku nr 4. Rastet e Viktimave të Dhunës në Familje të trajtuara në QPVDHF



Garantimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga monitorimet e realizuara në qendrat e përkujdesit

- Aktiviteti i monitorimit të IPSH-ve është realizuar në 29 IPSH gjithsej. Në 9 institucione monitorimi ka qenë prezent dhe tek të tjerat online për shkak të pandemisë së Covid-19. Janë lënë rekomandime në kuadrin e përmirësimeve të vazhdueshme të cilësisë së shërbimit që këto institucione ofrojnë për grupet në nevojë. Janë lënë rekomandime kryesisht për përmirësim të kushteve dhe investime në infrastrukturën e institucionit, rekomandimet janë për përmbushjen e standardeve dhe



rekomandime për plotësim stafi me punonjës në përputhje me standardet e miratuara dhe pjesa tjetër për zbatimin e protokolleve të Covid - 19 sipas target grupeve.

Komisionimet

Vlerësimi i kujdesshëm i kërkesave për sistemim në IPSH duke argumentuar interesin më të mirë të çdo përfituesi për marrjen e shërbimit pranë familjes, ka qenë fokus i punës së 4 komisionëve të ngritura në SHSSH për vlerësimin e nevojave për sistemim në IPSH të fëmijëve, të moshuarve, personave me aftësi të kufizuar dhe status jetimi.

- Në vitin 2020 janë sistemuar 6 raste me AK dhe ka pasur një rritje të kërkesave kryesisht mbi moshën 21 vjec. Në institucionet për persona me aftësi të kufizuar për vitin 2019 janë komisionuar 5 persona PAK (tabela nr.1) numri është pothuaj i njëjtë sepse mbi moshën 21 vjec nuk mund të marrin shërbim në qendra rezidenciale për PAK, pasi janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.
- Gjatë vitit 2020 janë sistemuar 47 fëmijë nga të cilat 22 nga SHSSH dhe 25 si raste emergjente dhe nga bashkitë. Gjatë vitit 2019 janë sistemuar 64 raste fëmijë ku 40 janë pranuar me vendim komisioni nga SHSSH. Nisur nga sa më sipër vërehet ulje të numrit të fëmijëve në IPSH publike pasi ka shërbime të tjera alternative dhe de-institucionalizimi i fëmijëve është prioritar (tabela nr.1).
- Gjatë vitit 2020 në Shtëpitë e të Moshuarve janë sistemuar 42 të moshuar në 120 kërkesa për sistemim, ndërkohë që numri i sistemimit të të moshuarve për vitin 2019 ka qenë 66 të moshuar në 174 kërkesa. Këto të dhëna tregojnë se në krahasim me vitin 2019 është ulur numri i rasteve për trajtim rezidencial pasi janë orientuar drejt shërbimeve alternative.
- Gjatë vitit 2020 në përputhje me ligjin Nr 8153 datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit” kanë përfituar Statusin e Jetimit 127 persona, nga të cilët 27 me prindër të vdekur dhe 100 fëmijë të lindur jashtë martese, ndërkohë që për vitin 2019 kanë përfituar Statusin e Jetimit 202 persona, nga të cilët 52 me prindër të vdekur dhe 151 fëmijë të lindur jashtë martese (tabela nr.3).
- Në QKTE gjatë vitit 2020 janë trajtuar 47 familje dhe 174 banorë ndërkohë gjatë vitit 2019 janë trajtuar 42 familje (166 banorë). Në sajë të bashkëpunimit intensiv me Bashkinë e Tiranës, me institucionet e punësimit dhe formimit profesional, institucionet e arsimit dhe edukimit si kopshte, shkolla e çerdhe janë integruar në komunitet 3 familje.
- Gjatë vitit 2020 në QKPVT janë trajtuar 10 raste, ndërkohë që për vitin 2019 janë trajtuar 10 raste.
- Gjatë vitit 2020 në QKPVDHF janë trajtuar 60 raste ku 47 janë raste të reja ndërkohë që janë integruar 51 raste.



Tabela nr.3 Pranimet me komision nga SHSSH dhe nga mekanizmat e referimit të VT/VMT dhe rastet e dhunës

Institucionet	Viti 2019	Viti 2020
IPSH për PAK	5 persona	6 persona
IPSH për fëmijët	57 fëmijë	45 fëmijë
IPSH për të moshuarit	66 të moshuar	42 të moshuar
Statusi jetim	202 raste me status	127 raste me status
VT/VMT	18 raste	10 raste
Raste të dhunës në familje	91 raste	60 raste

OBJEKTIVI III

MIRËMENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Drejtorja e Shërbimeve Sociale në planin e veprimit për vitin 2020 në realizimin e objektivit për mirëmenaxhimin e burimeve njerëzore e ka fokusuar punën e vet duke bashkëpunuar dhe me organizatat e ndryshme në fushën e shërbimit social për të realizuar trajnime të ndryshme si për stafet sociale ashtu dhe për Drejtorinë e Shërbimeve Sociale në SHSSH-së me qëllim rritjen e performancës së punonjëve. Kjo sjell rritjen e cilësisë së shërbimit nga ofruesit e shërbimeve dhe arrijten sa më të lartë të objektivave të Strategjisë së Mbrojtjes Sociale. Konkretisht janë realizuar trajnime/takime si më poshtë:

- Trajnimi i stafit on-line të 9 IPSH-ve për fëmijë mbi temën “Traumat e fëmijëve 0-18 vjeç të sistemuar në IPSH rezidenciale dhe teknikat për profesionistët në menaxhimin e tyre”.
- Trajnimi i stafit të sektorit social të DRSHS, të IPSH-ve mbi temën “Teknika praktike për të punuar me fëmijë dhe të rinjtë në kujdes alternativ që shfaqin probleme në sjellje”.
- Në kuadër të shtrirjes së Regjistrimit Elektronik të Shërbimeve Shoqërore janë kryer takime informuese dhe trajnime me administratorët shoqërorë/ të qarqeve Elbasan, Tiranë, Shkodër, Fier, Vlorë, Korçë.
- Trajnimi on-line nga SHSSH “Përdorimi i teknikave MINDFULNESS në reduktimin e ankthit ndaj COVID 19”.
- Trajnimi mbi temën “Mental Health and Psychosocial Support in Emergencies” nga MSHMS, UNICEF, WHOE.
- Trajnimi mbi temën “Shfrytëzimi seksual i fëmijëve për qëllim përfitimi në Shqipëri”
- Trajnimi mbi “Masat e marra për mbrojtjen kundër zjarrit” nga organizata CONCEPT- PRO.
- Trajnimi nga NISMA mbi temën “Institucionalizimi, Jeta në institucionet e përkujdesit shoqëror dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve në Shqipëri”.



OBJEKTIVI III

PËRFSHIRJA SOCIALE E GRUPEVE VULNERABLE

Zhvillimet e shërbimeve të kujdesit social bazohen në parimet e decentralizimit dhe deinstitucionalizimit, për përfshirjen e grupeve vulnerabël në programet e mbrojtjes sociale si dhe inkurajon pjesmarrje e plotë dhe efektive në shoqëri. Konkretisht si rrjedhojë janë realizuar si më poshtë:

- I gjithë programi i mbrojtjes sociale do të ofrohet dhe monitorohet nëpërmjet një sistemi të digjitalizuar në të gjithë vendin. Kjo për të patur më shumë transparencë dhe efikasitet. Lidhur me Regjistrin Elektronik të Shërbimeve Shoqërore është realizuar trajnimi i gjithë stafit të njësisve vendore, Drejtorive Rajonale të SHSSH-së dhe Drejtorisë së Shërbimeve Sociale në SHSSH. Aktualisht është bërë i mundur popullimi i regjistrit nga njësitë vendore.
- Hartimi i planit të veprimit për grupin LGBTI.
- Ofrimi i shërbimit në familje për të moshuar për shkak të situatës së COVID-19.



IV. DREJTORIA E FINANCËS DHE STATISTIKËS

Drejtoria e Financave dhe Statistikës në Shërbimit Social Shtetëror ka për mision zbatimin e politikave, legjislacionit të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimet shoqërore për:


- 29 Institucione të Përkujdesit Shoqëror,
- 12 Zyra Rajonale,
- Agjencisë Shtetërore të Mbrojtjes së Fëmijëve
- Administratën Qendrore të Shërbimit Social Shtetëror si dhe
- 61 Njësi Administrative.

Gjatë vitit 2020 nga ana e DFS janë vendosur disa objektiva të cilat bëjnë të mundur mbarëvajtjen e punës dhe realizimin në kohë dhe me cilësi të detyrave.

Objektivat e vitit 2020:

- Mirë-menaxhimi i fondeve buxhetore
- Mirë-menaxhimi i aseteve
- Bonusi i bebes
- Transparencë e plotë e shpenzimeve
- Korrupsion zero
- Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë
- Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror


Më poshtë numri i familjeve në skemën e NE gjatë 2020 për secilin qark i krahasuar me 2019



Grafik: Krahاسimi i numrit të familjeve në skemën e NE sipas Qarqeve.

Tregues: Numri mesatar i familjeve pjesë e skemës së Ndhmës Ekonomike për vitet 2019-2020 (pa përfshirë individët)

- Për vitin 2019 60.755 Familje
- Për vitin 2020 61.640 Familje






Grafik: Numri mesatar i përfituesve në skemën e NE

Duke e krahasuar numrin e familjeve në skemë me vitin 2019 kemi një rritje me 885 familje ose 1.4 %.

Tregues: Fondet e shpenzuara për skemën e NE

- Për vitin 2019 3.545.769.303 lekë
- Për vitin 2020 3.633.151.273 lekë




Grafik: Fondet e shpenzuara për familjet në skemën e NE

Gjatë vitit 2020 fondi i shpenzuar për familjet në skemën e NE është rritur me 87.3813970 lekë ose me rreth 2.4%, kjo pasi gjatë periudhës së pandemisë covid-19 është një dyfishim i NE mars-qershor për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme që u vendos.

Tregues: Numri mesatar i individëve pjesë e skemës së PAK për vitet 2019-2020(pa përfshirë kujdestar dhe invalid)

- Për vitin 2019 70.802 persona me AK
- Për vitin 2020 73.919 persona me AK




Grafik: Numri mesatar i përfituesve në skemën e PAK

Nga viti 2019 në vitin 2020, numri i individëve që përfshihen në pagesën e AK, është rritur me 2.887 persona.

Tregues: Fondet e shpenzuara për skemën e PAK


- Për vitin 2019 11.670.456.769 lekë
- Për vitin 2020 12.984.118.655 lekë



Grafik: Fondet e shpenzuara për individët në skemën e PAK

Tregues: Ecuria e fondeve duke përfshirë të gjithë komponentët e skemës së NE


- Për vitin 2019 4.250.384.764 lekë ose 99.37%
- Për vitin 2020 5.434.643.565 lekë ose 98 %



Grafik: Realizimi i fondeve për llogarinë 606 NE

Tregues: Ecuria e fondeve duke përfshirë të gjithë komponentët e skemës së PAK

- Për vitin 2019 15.860.125.268 lekë ose 99.84%
- Për vitin 2020 18.465.130.056 lekë ose 99%




Grafik: Realizimi i fondeve për llogarinë 606 PAK

Siç theksuam më lart, fondet e NE me të gjithë komponentët kanë pësuar rritje pasi për periudhën Maj - Qershor është dyfishuar NE, vijon të jetë në fuqi skema e re e NE.

Tregues: Financimet në lekë nga Buxheti i Shtetit: Kontributet me fonde të buxhetit të shtetit për të gjitha llogaritë në vite:

- 2019 23.435.009.578 lekë ose 99.57%

➤ 2020 23.849.260.000 lekë ose 99.87%




Grafik: Akordimi i fondeve për të gjitha llogaritë për vitet 2019-2020

Realizimi sipas zërave të buxhetit paraqitet si më poshtë:

A. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 600 paga është:

➤ 2019 464.244.797 lekë ose 99.35%
 ➤ 2020 462.393.000 lekë ose 88. %




Grafik: Akordimi i fondeve për llogaritë 600 për vitet 2019-2020

Realizimi i fondeve për llogarinë 600 është në masën 78%, një rezultat i lartë i cili tregon mirëmenaxhim të kësaj llogarie.

B. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 601 Sigurime Shoqërore është:



- 2019 78.169.239 lekë ose 95.33%
- 2020 69.802.178 lekë ose 78 %




Grafik: Akordimi i fondeve për llogaritë 601 për vitet 2019-2020

Realizimi i fondeve për llogarinë 602 është në masën 85 %, shkon në proporcion me realizimin e plotë të fondit të pagave.

C. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 602 shpenzime operative është:

- 2019 337.609.172 lekë ose 95.47%
- 2020 273.847.588 lekë ose 85 %



Grafik: Akordimi i fondeve për llogaritë 602 për vitet 2019-2020

Realizimi i fondeve të artikullit 602 është në masën 85%, ky realizim është në nivele të kënaqshme pavarësisht se në muajt Mars - Qershor 2020 institucionet kanë qenë në



karantinë, Pavarësisht kësaj një pjesë e vogël e institucioneve të varësisë kanë lënë fonde të papërdorura.


Realizimi i fondeve për llogarinë 600 është në masën 84%, një rezultat i lartë i cili tregon mirëmenaxhim të kësaj llogarie.

Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 600 Shperblime të punonjesve ne karantine është:

- 2020 28.092.941 lekë ose 84 %

D. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 606 Fond për financimin e Shërbimeve të përkujdesit në Bashki e Qarqe është:

- 2019 75.007.375 lekë ose 80%
- 2020 94.481.128 lekë ose 69%




Grafik: Ecuria e fondeve për financimin e shërb.përk. në Bashki dhe Qarqe

Realizmi për këtë tregues është 69%, krahasuar me 2019 që ishte 80%, pasi edhe nga Qarqet/Bashkitë të cilave fondi u është akorduar gjatë muajve të parë 2020 nuk i kanë mirëmenaxhuar fondet duke mos përdorur një fond prej 30.952.768 lekësh gjithashtu dhe bashkive të cilat iu financuan shërbimet gjatë viti 2020 nuk i kanë përdorur fare ato.

E. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 231 Investime është:

- 2019 1.264.422 lekë ose 13.3 %
- 2020 5.059.286 lekë ose 64 %



Grafik: Akordimi i fondeve për llogaritë 231 për vitet 2019-2020

Gjatë vitit 2020 SHSSH i është akorduar fond investimesh me destinacion “Projekt preventiva për rikonstruksione të institucioneve të përkujdesit Social”, “Rikonstruksion i zyrave në kuadër të reformës së vleresimit të PAK”, “Supervizion dhe kolaudim i Rikonstruksion i zyrave në kuadër të reformës së vleresimit të PAK”, “F.V. pajisje mobilimi për zyrat që do të ngrihen në kuadër të reformës së vleresimit të PAK”. Ndërkohë nga ana e SHSSH u realizuan me sukses 4 prokurime siç ishin “Blerje paisje për godinën e Drejtorisë Rajonale Tiranë”, “Pajisje kompjuterike për zyrat që janë ngrihen në kuadër të reformës së vleresimit të PAK” për Durrës dhe Elbasan,”Rehabilitim i zyrave të Drejtorisë Rajonale Tiranë dhe Elbasan “.

Nisur nga sa më sipër realizimi i kësaj llogarie është në masën 64%.

Në rënie në krahasim me vitin 2019 kanë rezultuar fondet për paga, sigurime shoqërore, Shpenzimeve Operative dhe me rritje ka rezultuar llogaria e NE dhe PAK, investimet e akorduar për qarqet dhe bashkitë.

Gjatë vitit 2020 SHSSH ju ngarkua një tjetër detyrë siç ishte dhe shpërndarja e çeqeve për bebet që lindin jashtë vendit dhe ato që lindin në spitalet private të vendit. Për periudhë Janar -Dhjetor 2020 SHSSH ka shpërndarë rreth 12.094 çeqe.

Ndërkohë gjatë vitit 2020 krahasuar me vitin 2019 problematikat kanë qenë të shumta, më poshtë disa prej tyre:

- Diferenca e madhe ndërmjet kërkesës së paraqitur në Projekt Buxhetin 2019-2021, kërkesës në fund të vitit 2019 dhe akordimit të fondeve për vitin 2020.
- Mungesa më e rëndësishme, ajo e fondeve të PAK, si pasojë e të cilës nuk u çel fondi për PAK deri muajin Tetor 2020.



- Akordimi i fondeve shtesë (pas dhjetra kërkesave zyrtare për shtesë fondesh duke filluar nga janari 2020) vetëm gjatë muajve të fundit solli mos kryerje të disa prokurimeve për mbarëvajtjen e punës në IPSH dhe DR në varësi të SHSSH.
- Akordimi i fondeve kundrejt bashkive ose qarqeve gjatë vitit, për financimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror dhe mospërdorimi i plotë nga ana e tyre.
- Plotësim i pasaktë i formularëve statistikor të dërguar në SHSSH Drejtoritë Rajonale, ç'ka sjell vështirësi nga ana jonë për mbylljen e analizave statistikore periodike në afatin e duhur, duke na detyruar të kërkojmë informacion shtesë herë pas here.
- Tek formularët statistikor të NE do të kishte një plotësim të saktë nese fondi 6% do të jepej në tabelë më vete, e cila ka sjell mos përputhje të dhënash në SHSSH.
- Pandemia covid-19 rriti numrin e familjeve në nevojë që trajtohen me ndihmë ekonomike.
- Lidhur me shpërndarjen e bonusit të bebes SHSSH ka hasur disa problematika siç ka që mungesa e informacionit të përfituesve të bonusit për dokumentacionin shoqëruar për marrjen e çekut. Zyrat e gjendjeve civile në të gjithë vendin plotësonin josaktësisht përshkrimin e përshkrimin e certifikatave të nevojshme për marrjen e çekut. Këto problematika kanë sjellë rradhë të gjata për tërheqjen e çekut dhe në shumë raste përfituesit janë kthyer disa herë për të plotësuar dokumentacionin.

PROPOZIM

Për shkak të problematikave të hasura gjatë vitit 2020 në formularët statistikor të NE do të ndihmonte një shtojcë shpjeguese e treguesve statistikorë për të shmangur problematikat e paraqitura më sipër, unifikimi i formularëve të dëdërguara pranë për NE dhe PAK pranë DPSHSSH .

Si dhe në dhënien e çeqeve propozojmë që dhënia e tyre të bëhet nga rrethet përkatëse, kjo për të shkurtuar shpenzimet për ardhjen nga rrethet në SHSSH si dhe për të shmangur problematikat e paraqitura më sipër.



V. SEKTORI I AUDITIT TË BRENDSHËM

Veprimtaria e auditimit të brendshëm bazohet në ligjin nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Manualin e Auditimit të Brendshëm miratuar me Urdhër 100, datë 25.10.2016, standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm dhe akte të tjera në fushën e auditimit të brendshëm.

Sektori i Auditimit të Brendshëm në Shërbimin Social Shtetëror mbulon me auditim Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH (5 Drejtori), 12 Drejtori Rajonale të SHSSH, 29 Institucione të Përkujdesit Shoqëror (IPSH), 17 prej të cilave janë në varësi strukturore të pushtetit vendor, por veprimtaria e tyre financohet nga Buxheti i Shtetit, nëpërmjet SHSSH. Gjithsej 41 subjekte dhe 5 Drejtori pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

5.1 Rezultatet e veprimtarisë së AB

Plani gjatë vitit 2020 është rishikuar për shkak të masave të marra në kuadër të parandalimit të përhapjes së pandemisë Covid- 19 dhe kërkesës së MFE për auditimin e detyrimeve financiare të prapambetura të krijuara në vite.

Në bazë të planit të rishikuar në vitin 2020 janë planifikuar 6 auditime. të cilat janë realizuar. Realizimi i planit është në masën 100 %. Konkretisht:

- 4 dosje auditimi janë evaduar dhe me kthim përgjigje nga subjekti për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve.
- 2 dosje auditimi ndodhen në procesin e raportimit të zbatimit të rekomandimeve (QKTVDHF dhe Auditimi i detyrimeve të prapambetura në 24 subjekte IPSH)

5.2.Fushat me risk dhe trajtimi i tyre

Në planifikim dhe angazhimet e ushtruara në subjektet e audituara janë përcaktuar edhe risqet kryesore të identifikuara dhe trajtuara në raportet e auditimit për të cilat janë lënë rekomandimet përkatëse për menaxhimin e riskut dhe përmirësimin e veprimtarisë.

- **Sistemi i pagave, shpërblime, trajtime** është konsideruar me nivel të lartë risku nga auditimi 2020:
 - Të ndodhur para një situatë jo të zakonshme për shkak të pandemisë COVID 19, ku në kuadër të masave të marra për parandalimin e përhapjes së saj, punonjëset e IPSH janë karantinuar. Shtesa e pagës për orët jashtë kohës normale të punës nuk është në përputhje me Kodin e Punës me ndryshime dhe aktet në zbatim të tij,
 - Mangësi në përlllogaritjen e pagës për periudhën e paaftësisë së përkohshme në punë.
 - Paga e grupit në 1 rast nuk është në përputhje me diplomën.
 - Mangësi në zbatimin e VKM 977/2010 “ Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim brenda vendit”, i ndryshuar.



- **Sistemi i Prokurimeve** është konstatuar nivel i mesëm risku për shkak se ka mangësi në zbatimin e akteve rregullore të fushës së prokurimeve:
 - Hartimi i regjistrimit të parashikimit dhe realizimit të prokurimeve publike, ka ardhur në përmirësim për shkak dhe të ndryshimeve në aktet rregullore.
 - Ka raste që Urdhërat e prokurimit dalin pa specifikuar mallin/shërbimin/punën që do të prokurohet në sasi e njësi, sipas formularit standart të blerjes me vlerë të vogël.
 - Mungesë të administrimit të përllogaritjes së fondit limit.
 - Kalimi nga ofertuesi i parë deri të ofertuesi i shpallur fitues nuk është dokumentuar sipas udhëzimeve për prokurimin blerje me vlerë të vogël.
 - Mungesë e deklaratës së konfliktit të interesit.
 - Mungesë e raportit përmbledhës të realizimit të kontratës.
 - Mosarkivimi i dosjes së prokurimit sipas ligjit “Për arkivën”.

- **Fusha e programimit dhe zbatimit të buxhetit** konsiderohet si sistem me risk të mesëm ku nga auditimet e kryera janë konstatuar mangësi në zbatimin e ligjit 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet në zbatim të tyre.
 - Programimi i fondeve për mallra e shërbime pa vlerësimin e indikatorëve dhe normave të shpenzimeve, nevojave dhe sasi të përfundimtare të produkteve dhe shërbimeve që do të kryhen, duke mos argumentuar kostot e programimit për shpenzime operative e shpenzime investimi.
 - Mangësi në regjistrimin e shpenzimeve sipas nomenklaturës së shpenzimeve.
 - Pagesa e faturave të kontraktorëve jashtë afatit kohor prej 30 ditë të përcaktuar në aktet rregullore, e cila sjell rritje të shpenzimeve financiare për shkak të penaliteteve të ndryshme.

- Në **sistemin e administrimit të pronës** është konstatuar një nivel i mesëm risku:
 - Mangësi në plotësimin e regjistrimit të aktiveve.
 - Mangësi në procedurat e inventarizimit, në ngritjen e komisioneve dhe procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimi.
 - Mangësi në hartimin e inventarëve sipas personave që i kanë në përgjegjësi aktivet.

- **Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar**
 - Nga auditimi i subjekteve janë konstatuar parregullësi në mbajtjen e evidencës kontabile, ditar i shpenzimeve në regjistrimin e transaksioneve dhe veprimet e mbylljes së llogarisë vjetore.
 - Mosevidentim i detyrimeve sipas rregullave kontabël.

- **Sistemi i kontrollit të brendshëm**
 - Drejtuesit e njësisë kanë përgjegjësinë e krijimit të sistemit të kontrollit të brendshëm (MFKB) në njësinë e tyre.
 - Mangësitë e konstatuara tregojnë dobësitë në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.
 - Menaxhimi i riskut vazhdon të jetë sfidë për institucionet. Njësitë në përgjithësi kanë hartuar regjistrin e riskut, por ka mangësi në përcaktimin e riskut që ndikon

në realizimin e objektivave, përcaktimin e kontrolleve për parandalimin e riskut dhe evidentimin e tyre.

- Ka mangësi në hartimin e rregullores së brendshme të funksionimit e cila nuk është në përputhje me manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin.
- Ka njësi që nuk evidentojnë proceset kryesore dhe nuk ka procedura të shkruara ku të përcaktohet aktiviteti dhe përgjegjësia, gjurma e auditimit për përputhjen me kontrollin e brendshëm.

5.3.Rekomandimet

Nga ana e auditëve për çdo gjetje të konstatuar dhe trajtuar është lënë rekomandimi përkatës për përmirësimin e fushës në të ardhmen dhe menaxhimin e riskut.

Nga institucionet ka pasur reagime pozitive duke pranuar 100 % rekomandimet e adresuara. Është përgjegjësi e titullarit të subjektit të audituar kthimi i përgjigjes brenda afatit 30 ditor, për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna në Raportin Përfundimtar. Ky afat është respektuar nga subjektet.

Pas kthimit të përgjigjes nga subjekti për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve është hartuar Memo për titullarin e Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH dhe për Kryetarin e Bashkisë për institucionet në varësi strukturore të pushtetit vendor.

Për 6 auditimet e kryera për të cilat është dërguar Raporti Përfundimtar, janë lënë gjithsej 53 rekomandime, afërsisht 9 rekomandime për subjekt.

Në tabelën më poshtë jepen subjektet e audituara dhe progresi i rekomandimeve të lëna nga auditimi në bazë të raportimit të subjekteve.

Nr	Struktura	Numri i Rekomandimeve	Pranuar	Realizuar	Proces
1	Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme SHSSH	9	9	9	0
2	Drejtoria e Kontrollit të NE dhe PAK SHSSH	5	5	1	4
3	Qendra Kombëtare Tranzitore e Emergjencës	9	9	9	0
4	Shtëpia e të Moshuarve Gjirokastër	10	10	9	1
	Total rekomandime	33	33	28	5
	Realizimi në %			84.8 %	15.2 %
Emërtimi i subjektit të audituar që është dërguar raporti përfundimtar					
5	Qendra Kombëtare e Trajtimin të Viktimave të Dhunës në Familje	10	10		10
6	Qendra e Zhvillimit Shkodër	4	4		4
7	Shtëpia e Foshnjës Durrës	3	3		3
8	Qendra e Zhvillimit Vlorë	1	1		1
9	Shtëpia e Fëmijëve 16-18 Vjeç Shkodër	2	2		2



Total rekomandime	20	20	20
Gjithsej rekomandime	53	53	28

Sa më sipër niveli i zbatimit të rekomandimeve sipas raportimit të 4 subjekteve, sepse 5 subjekte janë në procesin e raportimit brenda 30 ditësh nga marrja e raportit përfundimtar, është në masën rreth 84.8%.

Rekomandimet që sipas raportimit nga subjektet janë në proces janë kryesisht rekomandimet në sistemin e menaxhimit të aktiveve, subjektet janë në procesin e inventarizimit; në sistemin e kontabilitetit, subjektet janë në periudhën e hartimit të mbylljes së llogarisë vjetore; ndalesat për pagesa të marra jo në përputhje me aktet ligjore, janë në proces të përlllogaritjes dhe mbajtjes së tyre; në sistemin e kontrollit të brendshëm në process të rishikimit të regjistrit të riskut, kryerjes së raportimit vjetor me evidentimin e risqeve.

5.4.Sigurimi i brendshëm i cilësisë së veprimtarisë audituese

Rishikimi i cilësisë është kryer hap pas hapi deri në evadimin e dosjes për të krijuar një siguri të arsyeshme se po veprohet në përputhje me standardet, praktikat profesionale të auditimit të brendshëm dhe të kartës së auditimit. Referuar procedurave të përcaktuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm sqarohet se monitorimi dhe sigurimi i brendshëm i cilësisë për veprimtarinë audituese është realizuar gjatë gjithë procesit të auditimit nga audituesi, përgjegjësi i grupit dhe Përgjegjësi i Sektorit të Auditimit.

Është hartuar nga Përgjegjësi i Sektorit të Auditimit të Brendshëm dhe miratuar nga Titullari i SHSSH, Programi i sigurimit të brendshëm të cilësisë, ku janë përcaktuar dhe indikatorët e matjes së performancës për rishikimin e auditimeve të kryera, me qëllim që të sigurohet vlerësimi i veprimtarisë audituese në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranura.

Janë plotësuar anekset përkatëse sipas kriterëve të vendosura nga auditët, përgjegjësi i grupit dhe përgjegjësi i sektorit. Gjatë rishikimit të cilësisë janë lënë rekomandime në drejtim të rritjes së cilësisë, vendosjes drejt të referencave ligjore, të trajtimit të gjetjes mbështetur të Udhëzimi i MFE, të cilat janë marrë parasysh dhe reflektuar.

VI. DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME

Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme ka ushtruar veprimtarinë në përputhje me planin vjetor të miratuar nga Drejtori i përgjithshëm në tri sektorët e saj si më poshtë.

I. SEKTORI I SHËRBIMEVE TË BRENDSHME

OBJEKTIVI

MIRËMENAXHIMI I ÇËSHTJEVE TË BURIMEVE NJERËZORE NË INSTITUCION

Gjatë vitit 2020 Sektori i Burimeve Njerëzore ka kryer veprimtarinë e tij sipas rezultateve konkrete të parastruara më poshtë:

	Emërimet			
	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018	Viti 2017
Emërimet me konkurs (DAP + SHSSH)	41	46	39	13
Emërimet tjera (part-time+ IPSH e re + ekselencia)	65	56	8	15
Emërimet gjithsej	106	102	47	28

	Lirimet			
	Viti 2020	2019	2018	2017
Lirime me dorëheqje	30	38	26	19
Lirime për shkak të daljes në pension	11	6	7	5
Lirime për shkak të thyerjes së disiplinës	1	1	7	20
Lirime gjithsej	42	45	40	44

	Të tjera			
	Viti 2020	2019	2018	2017
Masa Disiplinore	4	2	16	20

Tabela e mësipërme paraqet në mënyrë krahasimore veprimtarinë e Sektorit të Shërbimeve të Brendshme përgjatë 4 viteve. Siç mund të vërehet numri i emërimeve në detyrë ka ardhur vit pas viti në rritje, gjë e cila justifikohet me emërimet e kryera nga Programi i Praktikave të Punës, Programi për punësimin e studentëve ekselentë, si edhe hapja e një IPSH të re.

Numri i lirimeve vit pas viti ka ndryshuar, ku duket qartazi se pjesa më e madhe e lirimeve janë kryer me vullnetin e vetë punonjësve.



II. SEKTORI JURIDIK

OBJEKTIVI I

NDJEKJA E PROCESIVE GJYQËSORE KU SHSSH ËSHTË PALË E PADITUR

Gjatë vitit 2020 janë çelur disa procese gjyqësore, nga të cilat:

- 5 procese për largime nga puna;
- 3 procese kundër vendimeve të KMCAP Epror;
- Asistimi në procese gjyqësore për persona që kanë marrë urdhër mbrojtje dhe janë sistemuar në IPSH.

Në tabelën e mëposhtme jepen në mënyrë krahasimore gjyqet e fituara nga SHSSH.

Procese gjyqësore të fituara nga SHSSH			
Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018	Viti 2017
3	7	4	1

Shënim: Gjatë vitit 2020 numri i gjyqeve të ndjekura nuk ka qenë i lartë për shkak të mbylljes së proceseve gjyqësore nga pandemia e Covid-19. Kjo ka bërë që gjatë vitit 2020 të kenë mbetur çështje gjyqësore në ndjekje.

Risi e vitit që prej 2017 ka qenë pjesëmarrja e institucionit në proceset gjyqësore për urdhrat e mbrojtjes të lëshuar nga Gjykata, në zbatim të Ligjit nr. 121/2016 “Për Shërbimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”. Përfaqësuesi i SHSSH në këto procese shpreh mendimin për sistemimin e fëmijës në institucione rezidenciale sipas nevojave dhe moshës së fëmijës.

OBJEKTIVI II

ORGANIZIMI I MBLEDHJEVE TË KOMISIONIT NË ZBATIM TË LEGJISLACIONIT PËR PËRJASHTIMIN DOGANOR PËR PERSONAT QË GËZOJNË STATUSIN E PARA-TETRAPLEGJISË

Gjatë vitit 2020, Shërbimi Social Shtetëror ka pajisur me vërtetim për përjashtim nga detyrimet doganore të automjeteve në pronësi të 24 personave me status para/tetraplegjie.

Në tabelën më poshtë jepet krahasimi ndër vite:

Vitet	Vërtetime
2013	49
2015	26
2016	28
2017	24
2019	14

Siç reflektohet në tabelë, shifrat kanë ardhur në rënie, si rezultat i kontrolleve nga ana jonë mbi përdorimin e makinave vetëm për lëvizjen e personave të sëmurë dhe jo për qëllime familjare të të afërmeve të personave me status para/tetraplegjie.

OBJEKTIVI III

SHQYRTIMI I KONTRATAVE DHE MARRËVESHJEVE TË BASHKËPUNIMIT TË LIDHURA MES SHSSH, INSTITUCIONEVE TË VARËSISË OSE OJF-VE NË FUSHËN E SHËRBIMEVE SHOQËRORE

Gjatë vitit 2020 janë shqyrtuar dhe miratuar 2 Marrëveshje Bashkëpunimi të lidhura nga IPSH me organizata jo fitimprurëse që operojnë në fushën e shërbimeve shoqërore dhe 1 Marrëveshje me FSHDPAK për karrige me rrota për PAK.

OBJEKTIVI IV

SHPËRNDARJE PËR NJOHJE DHE ZBATIM I AKTEVE LIGJORE/NËNLIGJORE NË FUSHËN E SHËRBIMEVE SHOQËRORE

i. Shpërndarja e bazës ligjore

Gjatë vitit 2020 përmes monitorimit të Fletores Zyrtare janë shpërndarë për njohje dhe zbatim:

- 12 Urdhra;
- 1 Ligj;
- 20 VKM;

Përveç shpërndarjes për njohje dhe zbatim në strukturat e SHSSH, kjo bazë ligjore është përditësuar në faqen e web-it të SHSSH.

ii. Problematikat e raportuara nga SHSSH në MSHMS

SHSSH ka raportuar për ri-kujtesë Projekt-Udhëzimin për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin nr. 1460, datë 30/07/2008 “për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të nevojshëm për dhënien e përfitimit në zbatim të VKM nr. 869, datë 18/06/2008 “Për zbatimin e Ligjit nr. 7889, datë 14/12/1994 “Për statusin e invalidit”.

III. SEKTORI I PROJEKTEVE

Sektori i Projekteve ka si mision sigurimin e ciklit të përgatitjes së projekteve sipas nevojave të Drejtorisë së Përgjithshme dhe institucioneve të varësisë, si edhe garantimin e transparencës së veprimtarisë së Shërbimit Social nëpërmjet komunikimit transparent dhe ndërveprues me strukturat e varësisë, median, partnerët dhe publikun e gjerë.



OBJEKTIVI I NDJEKJA E CIKLIT TË PROJEKTEVE

i. Projektet

Fokusi primar i sektorit është ndjekje e ciklit të projekteve, që nga diskutimi i ideve, tek shkrimi në bashkëpunim me ekipin, implementimi dhe vlerësimi i tyre. Gjatë vitit 2020, mbështetur në një thirrje për projekte nga BE, Sektori i Projekteve në bashkëpunim me specialistët e shërbimeve sociale dhe organizatën “Ndihmoni Jetën” hartoi një koncept-note projekti lidhur me jetesën e pavarur të personave me aftësi të kufizuara, për të cilën nuk u aplikua për shkak të anulimit të thirrjes nga BE në datë 08 Tetor 2020.

Së fundmi, BE ka rihapur një tjetër thirrje për projekte, për të cilën do të punohet gjatë fillimit të vitit 2021 dhe do të përmbillet aplikimi në datë 22 Janar 2020. Në momentin e aprovimit të koncept-notes, procesi do të vijojë më hartimin e projekt propozimit të plotë.

ii. Aktivitete të koordinuara nga Sektori i Projekteve

Gjatë vitit 2020, për shkak të gjendjes së emergjencës së shkaktuar nga pandemia e Covid-19, Sektori i Projekteve ka koordinuar më pak aktivitete krahasuar me vitet e mëparshme. Nuk ishte e mundur të koordinoheshin/organizoheshin aktivitete gjatë periudhës së karantinimit të IPSH, megjithatë u koordinuan aktivitetet më poshtë:

- 1 Tetor - Dita Ndërkombëtare për të Moshuarit
- Tetori – Muaji i Anti-Trafikimit
- 20 Nëntor - Dita Botërore e të Drejtave të Fëmijëve
- 25 Nëntor – 10 Dhjetor - Ditët e aktivizimit kundër dhunës ndaj gruas
- 3 Dhjetor - Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara
- Festat e Fundvitit (vetëm me pjesën e shpërndarjes së dhuratave).

OBJEKTIVI II THELLIMI I TRANSPRENCËS SË AKTIVITETIT TË SHSSH

iii. Zbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga Programi i Transparencës

Gjatë vitit 2020 në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është bërë transparente veprimtaria e Shërbimit Social Shtetëror dhe strukturave të varësisë përmes përditësimit koherent të faqes zyrtare të web-it dhe komunikimit në rrjetet sociale.

Arritje konkrete gjatë vitit 2020:

- Janë publikuar 12 Buletine Informative dhe 12 Buletine të Donacioneve, të cilat pasqyrohen çdo muaj brenda datës 10 në faqen zyrtare të SHSSH;
- Është bërë përditësim i Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve çdo 3 muaj, si edhe Regjistri vjetor përfundimtar;



- Janë përditësuar rubrikat e raporteve çdo 2 muaj dhe rubrikat e legjislacionit dhe njoftimeve sipas rasteve;
- Janë mbajtur të përditësuara çdo ditë rrjetet sociale zyrtare me postime rreth veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme, Drejtorive Rajonale dhe Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror.

Në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, Koordinatori për të Drejtën e Informimit në SHSSH i ka kthyer 66 përgjigje pa pagesë kërkesave për informacion drejtuar institucionit nga gazetarë investigativë, qytetarë, organizata apo grupe interesi. Në të gjitha rastet janë respektuar standardet ligjore të transparencës dhe afatet e kthimit të përgjigjeve. Përveç kthim përgjigjeve zyrtare, Koordinatori për të Drejtën e informimit ka realizuar 3 dalje mediatike për raste ankesash të ardhura nga televizione.

Kërkesat për informacion të ndara sipas objektit		
NE	PAK	Të tjera
10	21	35

Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë krahasuese të dhënat për kthim përgjigjet nga Koordinatori për të Drejtën e Informimit përgjatë 4 viteve.

Kërkesat për informacion të trajtuara nga SHSSH			
Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018	Viti 2017
66	85	110	65

Nga tabela reflektohet fakti se numri i kërkesave përgjatë viteve ka ardhur në ulje, pasi qytetarët kanë pasur më shumë mundësi të informohen edhe përmes rrjeteve sociale zyrtare të SHSSH.

iv. Marrëdhëniet me publikun

Në fokus të Sektorit të Projekteve është edhe përmirësimi i imazhit publik të SHSSH duke ndërtuar një sistem të komunikimit të drejtpërdrejtë me qytetarët, median, partnerët etj., e cila është arritur përmes faqes zyrtare në web, adresës elektronike info@sherbimisocial.gov.al, Portalit të Bashkëqeverisjes, si edhe rrjeteve sociale zyrtare.

Konkretisht gjatë vitit 2020 Sektori i Projekteve ka punuar për trajtimin e të gjitha ankesave dhe kërkesave të qytetarëve për problematika të ndryshme dhe vendosjes së urave të bashkëpunimit me institucionet përkatëse për kthimin e përgjigjes qytetarit brenda afateve ligjore.

Arritje konkrete sipas tabelës më poshtë:

Sqarime/kthim përgjigje zyrtare të ndara sipas burimit

Viti	Rrjete Sociale Zyrtare	E-mail	Telefon/Institucion	Portali i Bashkëqeverisjes
2020	690	47	129	1490
2019	496	-	-	1264
2018	110	-	-	962
2017	65	-	-	-

Krahasuar me vitin 2019 shifrat e raportuara janë më të larta për shkak se pandemia e Covid-19 rriti komunikimin e qytetarëve me institucionin për ndihmë. Kryesisht ka një rritje të rasteve të ankesave/kërkesave të ardhura në rrjetet sociale zyrtare (690 gjatë 2020 krahasuar me 496 gjatë vitit 2019) dhe në Portalin e Bashkëqeverisjes (1490 në 2020 krahasuar me 1264 në 2019).

Rastet e trajtuara në Portalin e Bashkëqeverisjes kanë qenë të shumta veçanërisht gjatë periudhës së funksionimit të “Kanalit të Urgjencës së shkaktuar nga Covid-19”. Gjatë të gjithë periudhës së funksionimit të kanalit të urgjencës, të gjitha ankesat e ardhura janë trajtuar dhe kthyer përgjigje brenda 24 orëve.

v. *Monitorimi i medias*

Gjatë vitit 2020 janë identifikuar dhe trajtuar 110 raste mediatike. Niveli i rasteve mediatike të identifikuara dhe trajtuara përgjatë viteve ka ardhur duke u rritur. Tabela më poshtë paraqet të dhënat në mënyrë krahasuese për numrin e rasteve mediatike ndër vite.

Raste mediatike të trajtuara në SHSSH			
Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018	Viti 2017
110	87	93	47

Arsyeja kryesore e rritjes së shifrave janë vështirësitë ekonomike të prodhuara nga pandemia. Nga statistikat e mbajtura nga specialistët e sektorit, situata rezulton si më poshtë:

Raste mediatike sipas muajve	
Mars 2020	21 raste
Prill 2020	31 raste
Maj 2020	16 raste

Niveli kulmor i rasteve mediatike vjetore rezulton të jetë gjatë periudhës së karantinës kombëtare.

Në kuadër të ankesave të qytetarëve drejtuar SHSSH, Koordinatorin për të Drejtën e Informimit ka realizuar 4 dalje mediatike për sqarimin e rasteve.



OBJEKTIVI III NDËRTIMI I PARTNERITETEVE

vi. Marrëdhëniet me botën akademike dhe rrjetin e vullnetarëve të SHSSH

Shërbimi Social Shtetëror ka përpiluar një marrëveshje të re bashkëpunimi me Universitetet publike dhe private për realizimin e praktikave mësimore. Një nga vështirësitë e hasura gjatë vitit 2020 me praktikat mësimore lidhet me periudhën e karantinimit kombëtar e më pas më vazhdimin e karantinës në IPSH ku mund të zhvilloheshin praktikat.

Në 2 muajt e parë të vitit u pritën 10 studentë për praktika mësimore, 6 prej të cilëve arritën ta përfundonin me sukses praktikën përpara karantinës, ndërsa 4 studentë të tjerë ishte e pamundur të sistemoheshin. Për shkak të Covid-19 kërkesat për praktika kanë ardhur në ulje krahasuar me vitet e mëparshme.

Nga ana tjetër, në përputhje me nevojat dhe kërkesat e institucioneve tona për vullnetarë u realizua sistemimi i 1 vullnetari në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Fier. Gjatë vitit 2020 Regjistri i Vullnetarëve u përditësua me 2 kërkesa të reja për vullnetarizëm, 1 prej të cilave për shkak të karantimit të IPSH ishte e pamundur të sistemohej. Regjistri i Vullnetarëve është i plotë, i përditësuar, duke pasqyruar në mënyrë të plotë gjeneralitetet dhe profesionet.